

Procesverbal

Konsultim publik: *Me komunitetin egjiptian dhe grupet vulnerabël*

Data : 21/11/2024

Ora: 12:00

Vendi: Pallati i Kulturës, kati i 2-të

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 13 persona të pranishëm. (5 gra dhe 7 burra).

1. Titulli i Projekt – aktit që konsultohet: Projekt draftet programi buxhetor afatmesem 2025-2027, paketa fiskale dhe planifikimi për buxhetin e vitit 2025.

2. Pjesëmarrës :

1. **Valbona Cela** (Sekretare Këshilli)
2. **Spiro Kora** (Nënkryetar I bashkisë)
3. **Vladimir Bakiaj** (Anëtar Keshilli)
4. **Ilir Haska** (Anëtar Këshilli)

Takimi drejtohet nga Nënkryetari Bashkisë Z.Spiro.Kora;

- ✓ Prezantim të punëve dhe detyrave të realizuara përgjatë vitit 2024 dhe zbatimin e buxhetit.
- ✓ Prezantoi investimet dhe punët e kryera përgjate vitit 2024
- ✓ Sqaroi mbi shpërndarjen buxhetore të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2025, PBA 2025-2027, Paketa Fiskale 2025, propozimet e grumbulluara përgjate muajve si dhe shtroi kërkesën për nevojat te tjera qe lidhen me njësinë Administrative Qytet.
- ✓ Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- ✓ Informoi për të propozuar një nismë në buxhetin e vitit 2025, me qëllim përmirësimin e jetesës dhe kushteve për këtë komunitet.
- ✓ Ju dha fjalën pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet si vijon:

- **Banore e qytetit Tepelenë, Antoneta Cunaj**

Ju falenderojmë për këtë takim, pasi sic dihet problemet në komunitetin tonë janë të shumta. Shërbimet e ofruara nga bashkia kanë qenë gjithmonë ndihmuese për të përmirësuar jetesën tonë. Personalisht jam zgjidhur shumë here për probleme të ndryshme që kam patur. Ne do ta

bisedojmë midis njëri tjetrit dhe do flasim e ju për te bërë një projekt që të na ndihmojë sado pak edhe ne.

- **Banor i qytetit Tepelenë, Shkëlqim Cunaj**

Sic thate e dhe ju nënkryetar, eëhtë shumë i nevojshëm qe ne të kemi mbështjetjen e bashkisë për të rregulluar ca gjëra të jetës tonë. Jo se bashkia nuk ka qenë mbështetese, pasi ne jemi ndihmuar edhe për punësim por edhe kjo qe ju na propozoni është shumë e mirë. Mund të jetë ndonjë nisme për fëmijet tanë, ose për të moshuarit me tepër.

Mbajtese e P/Verbalit Sekretare Këshillit

Valbona Çela







